



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
SHËRBIMI PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME
DHE ANKESAT

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
INPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS / POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA
POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO
ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE
HYRESE

No./Sr./No. 02-231 Pril./Bil./Pr. pg. f-15
Data/Datum/Date 15.07.2016
PRISHTINE / PRISTINA - PRISTINA



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME /
MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA
INPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS /
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA

Raporti i Përbashkët Inspektimi

**VLERËSIMI I EFIKASITETIT TË PATRULLIMEVE TË
PËRBASHKËTA TË POLICISË SË KOSOVËS DHE
SHQIPËRISË PËRGJATË VIJËS KUFITARE
KOSOVË-SHQIPËRI**



KORRIK 2016

ARBEN SKENDO

Drejtor i SHÇBA



HILMI MEHMETI

Kryeshef Ekzekutiv i IPK - së



SHKURTESAT

RK	Republika e Kosovës
RSH	Republika e Shqipërisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
PK	Policia e Kosovës
PSH	Policia e Shqipërisë
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DPSH	Drejtoria e Policisë së Shtetit
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
SHÇBA	Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat
DI	Departamenti i Inspektimeve
DIA	Drejtoria e Inspektimit dhe Ankesave
DRPK	Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare
DVMK	Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1.1 Në bazë të Ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës Nr. 03/L-231, neni 24 pika 1, 2, Ligjit të Shërbimit për Çështje të Brendshme dhe Ankesa të Shqipërisë Nr. 70/2014, neni 61, pika 1 dhe neni 64 pika 1 si dhe në përputhje me Planin e Veprimit të miratuar në ndërmjet Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së dhe Drejtorit të Përgjithshëm të SHÇBA-së, njësitë e Inspektimit të të dy vendeve kanë zhvilluar Inspektim të jashtëzakonshëm/të pa planifikuar nga data 20.04.2016 deri me 27.04.2016.

1.2 Inspektimit në këtë fushë i ka paraprirë, hartimi i programit inspektues duke përfshirë edhe përzgjedhjen e metodologjisë së punës si dhe Plan-Veprimi i nënshkruar nga dy institucionet përkatës siç janë: IPK dhe SHÇBA. Programi inspektues ka paraparë fillimin e aktivitetit inspektues në terren më datë 20.04.2016 dhe është zhvilluar në bazë të protokollit zyrtar të inspektimit.

1.3 Inspektimi në këtë fushë është shtruar si nevojë për tu siguruar që dy policitë kufitare konkretisht Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare Perëndimi Kosovë dhe Drejtoria Vendore për Kufi dhe Migracion Kukës Shqipëri janë duke respektuar Protokollin ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë “Mbi patrullimin e Përbashkët përgjatë Kufirit Shtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë” si dhe Marrëveshja Teknike e Mirëkuptimit ndërmjet Drejtorisë Rajonale të Policisë Kufitare Perëndimi Kosovë dhe Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Kukës Shqipëri “Mbi implementimin e protokollit të bashkëpunimit të patrullimeve të përbashkëta përgjatë kufirit shtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë”.

1.4 Të dy strukturat policore kufitare kanë treguar gatishmëri dhe janë angazhuar në implementimin e Protokollit “Mbi patrullimin e Përbashkët përgjatë Kufirit Shtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë” të nënshkruar në mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës ku si rrjedhë të këtij angazhimi kanë hartuar Marrëveshjen Teknike të Mirëkuptimit “Mbi implementimin e protokollit të bashkëpunimit të patrullimeve të përbashkëta përgjatë kufirit shtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë” ndërmjet DRPK-Perëndimi dhe DVKM-Kukës, të cilat dokumente në parim janë respektuar nga ana e dy policive gjegjëse.

1.5 Të gjeturat gjatë inspektimit kanë treguar se dy strukturat policore kufitare kanë respektuar në përpikëri rregullat e përcaktuara në Protokoll “Mbi patrullimin e Përbashkët përgjatë Kufirit Shtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë” lidhur me zonën e veprimit, kompetencat e patrullave të përbashkëta, të drejtat e uniformave zyrtare, bashkërendimi i punës së patrullave të përbashkëta, mënyra e punës, përbërja e patrullave të përbashkëta, drejtimi i patrullave të përbashkëta, mjetet e policisë, mjetet e komunikimit, uniforma, pajisje dhe armatim, veprimi, përgjegjësia penale dhe civile, sëmundja ose dëmtimi, dhe trajnimi.

1.6 Inspektimi ka vënë në pah se tek dy strukturat policore kufitare ka çështje të cilat nuk kanë arritur që të përmbushin në tërësi pikat e përcaktuara në Protokoll “Mbi patrullimin e Përbashkët përgjatë Kufirit Shtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë” dhe Marrëveshjen Teknike të Mirëkuptimit “Mbi implementimin e protokollit të bashkëpunimit të

patrullimeve të përbashkëta përgjatë kufirit shtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë "në mes dy drejtorive rajonale kufitare, të cilat çështje janë identifikuar tek rregullat për: dërgimin në punë të patrullave të përbashkëta, urdhërimi i patrullave të përbashkëta, instruktimi dhe raportimi, analiza e veprimtarisë së patrullave të përbashkëta, kohëzgjatja dhe numri i patrullave orari (grafiku) i angazhimeve, takimet dhe analiza.

1.7 Për shpjegime të mëtejme, çështjet konkrete të përcaktuara në protokoll "Mbi patrullimin e përbashkët përgjatë Kufirit Shtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë" që nuk kanë arritur të përmbushen nga ana e dy strukturave policore kufitare janë se në disa raste kopjet e listës së patrullimeve të përbashkëta nuk ju kanë dorëzuar oficerit të palës tjetër kontraktuese, kopjet e urdhër shërbimit nuk janë plotësuar në të gjitha hapësirat e këtij formulari si dhe nuk ju kanë dorëzuar oficerit të palës tjetër kontraktuese, raportet e analizës së veprimtarisë së patrullimeve të përbashkëta janë paraparë në raportet e përgjithshme duke mos i potencuar me theks të veçantë këto patrullime të përbashkëta. Gjithashtu të dy strukturat policore kanë përpiluar raporte për patrullimin e realizuar por jo në të gjitha rastet pala pritëse ka pajisur palën tjetër në patrullime të përbashkëta me kopje të raportit të patrullimit.

1.8 Sa i përket çështjeve të përcaktuara në Marrëveshjen Teknike të Mirëkuptimit "Mbi implementimin e protokollit të bashkëpunimit të patrullimeve të përbashkëta përgjatë kufirit shtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë" të të dy drejtorive rajonale kufitare dy strukturat policore për shkak të burimeve njerëzore, reliefit, kushteve atmosferike kanë arritur që të realizojnë vetëm njëqind e dyzet e tetë (168) patrullime të përbashkëta nga dyqind (200) sa i ka përcaktuar marrëveshja. Po ashtu palët kontraktuese gjithnjë duke u bazuar në vlerësimin e riskut dhe analizës të të dy palëve nuk kanë ndryshuar reciprocitetin e numrit të patrullimeve. Ndërsa për shkak se dy strukturat policore kufitare kanë një dallim në përbërjen strukturore (organik) takimet në mes përgjegjësve të stacioneve policore Ponoshec-Kosovë dhe Qafë-Morinë-Shqipëri nuk kanë arritur të realizoheshin.

1.9 Të gjeturat tregojnë se të dy strukturat policore duke kryer patrullime të përbashkëta nuk kanë pasur ndonjë rezultat në aspektin reaktiv të veprave penale ndërkuftare, por kanë treguar efikasitet në parandalimin e veprave penale ndërkuftare si një detyrë dhe qëllim kryesor i patrullimit.

1.10 Lidhur me të gjeturat e paraqitura në këtë raport, IPK me datë 10.06.2016, ka mbajtur takimin përmbyllës me menaxhmentin e PK-së dhe PSH-së të fushës përkatëse. Në këtë takim janë diskutuar të gjitha detajet e paraqitura në raport ku si konkluzion i këtij takimi ka dalë se të gjithë të pranishmit janë pajtuar me këto të gjetura.

2. HYRJE

2.1. Në bazë të Ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës Nr. 03/L-231, neni 24 pika 1, 2, Ligjit të Shërbimit për Çështje të Brendshme dhe Ankesa të Shqipërisë Nr. 70/2014, neni 61, pika 1 dhe neni 64 pika 1 si dhe në përputhje me Planin e Veprimit të miratuar në ndërmjet Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së dhe Drejtorit të Përgjithshëm të SHÇBA-së, njësitë e Inspektimit të të dy vendeve kanë zhvilluar Inspektim të jashtëzakonshëm/të pa planifikuar nga data 20.04.2016 deri me 27.04.2016.

2.2 Ky inspektim është bërë në strukturat përkatëse policore të të dy vendeve konkretisht në Departamentin për Kufi në Republikën e Kosovës dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë Kufitare në Republikën e Shqipërisë, me temën **“Vlerësimi i Efikasitetit të Patrullimeve të Përbashkëta të Policisë së Kosovës dhe të Shqipërisë përgjatë vijës kufitare Kosovë-Shqipëri”**.

2.3 Qëllimi i këtij inspektimi ka qenë vlerësimi dhe respektimi i detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit Ministrave të Republikës së Shqipërisë “Mbi Bashkëpunimin Policor Ndërkufitar” Protokollit “Mbi Patrullimin e Përbashkët përgjatë kufirit Shtetëror të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë”, Marrëveshjes Teknike të Mirëkuptimit ndërmjet Drejtorisë Rajonale të Policisë Kufitare Perëndimi-Kosovë dhe Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Kukës-Shqipëri “Mbi implementimin e protokollit të bashkëpunimit të patrullimeve të përbashkëta përgjatë kufirit shtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë” si dhe dhënien e rekomandimeve për mënyrat e përmirësimit të kryerjes së detyrave policore në të ardhmen.

2.4 Objekt i inspektimit është vlerësimi i efikasitetit të patrullimeve të përbashkëta të Policisë së Kosovës dhe të Shqipërisë përgjatë vijës kufitare Kosovë-Shqipëri ku subjekt i inspektimit janë Policia Kufitare Kosovë-Shqipëri, në nivelin qendror, rajonal dhe lokal.

2.5 Në kuadër të planifikimit të aktiviteteve nga Njësia Inspektuese (Departamenti i Inspektimeve të IPK-së dhe Drejtoria e Inspektimit dhe Ankesave të SHÇBA-së) janë përcaktuar këto objektiva:

- Vlerësimi i respektimit të Protokollit dhe mbarëvajtjes për patrullime të përbashkëta dhe
- Vlerësimi i performacës policore dhe rezultatet e patrullimeve të përbashkëta në luftën kundër migracionit ilegal dhe krimit ndërkufitar.

2.6 Të autorizuar të kryejnë inspektim të jashtëzakonshëm IPK-ja dhe SHÇBA-ja ka angazhuar inspektorët, të cilët në vazhden e nxjerrjes së informacionit të duhur, kanë siguruar:

- dokumente të shkruara (raporte- analiza të punës, orare të patrullimeve-grafikone, urdhra operativ, urdhër shërbime, procesverbale, lista të trajnimeve)
- intervista nga punonjës policorë të nivelit të lartë drejtues dhe nivelit zbatues si në vijim:
 - Drejtori i Departamentit për Kufi Republika e Kosovës;
 - Drejtori i Përgjithshëm për Kufirin, Republika e Shqipërisë;
 - Drejtori i Divizionit për Kontroll dhe Mbikëqyrje të Kufirit RK-së;

- Drejtori i Drejtorisë për Kufirin RSH-së.
- Drejtori Drejtorisë Rajonale Policor Perëndimi-Kosovë;
- Drejtori i Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Kukës-Shqipëri ;
- Shefin për Mbikëqyrje Kufitare të Stacioneve Policore Perëndimi-Kosovë;
- Specialist për Analizën e Riskut dhe Statistika në DVMK Kukës-Shqipëri;
- Komandant Stacioni për Mbikëqyrje të Kufirit Vermicë, Ponoshec dhe Dragash
- Shef Stacioni Policor të Kufirit, Morinë, Shishtavec, dhe Qafë - Morinë;
- Zyrtarë policor të përfshirë në patrullime të përbashkëta;

2.7 Inspektimi i jashtëzakonshëm/paplanifikuar i autorizuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së dhe Drejtori i përgjithshëm i SHÇBA-së është bazuar në këtë kuadër ligjor:

- Ligji i Policisë së Republikës së Kosovës (2011/04-L-076);
- Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Republika e Shqipërisë;
- Ligji nr. 04/L-072 “Për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror” Republika e Kosovës
- Ligji nr. 9861, datë 24.01.2008, “Për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror” të Republikës së Shqipërisë;
- Protokollin ndërmjet MPB të Republikës së Kosovës dhe MB të Republikës së Shqipërisë “Mbi patrullimin e përbashkët përgjatë kufirit shtetëror midis RK-së dhe RSH-së” të nënshkruar më 10 mars 2012 (në tekstin në vijim Protokollin).
- Marrëveshja Teknike e Mirëkuptimit ndërmjet Drejtorisë Rajonale Kufitare Perëndimi – Kosovë dhe Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Kukës-Shqipëri “Mbi implementimin e protokollit të bashkëpunimit të patrullimeve të përbashkëta (përziera) përgjatë kufirit shtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë” të nënshkruar më 18 prill 2012 (në tekstin në vijim Marrëveshja Teknike e Mirëkuptimit).

2.8 Periudha e vlerësuar në këtë raport inspektimi përfshin vitin 2015.

2.9 Fushat e inspektimit:

- Burimet njerëzore,
- Çështjet ligjore, profesionale e organizative,
- Evidentimi
- Logjistika
- Vështirësitë dhe pengesat e paraqitura në zbatimin e Protokollit “ Mbi patrullimin e përbashkët përgjatë kufirit shtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë ” dhe Marrëveshjes Teknike të Mirëkuptimit “Mbi implementimin e protokollit të bashkëpunimit të patrullimeve të përbashkëta përgjatë kufirit shtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë”.

2.10 Metodologjia :

- Kqyrja, administrimi dhe vlerësimi i dokumentacionit.
- Intervistime me punonjës të strukturës

- Për hartimin e këtij raporti është bërë analizimi i akteve ligjore përkatëse, respektivisht Protokollit ndërmjet MPB të Republikës së Kosovës dhe MB të Republikës së Shqipërisë “Mbi patrullimin e përbashkët përgjatë kufirit shtetëror të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë dhe Marrëveshjes Teknike të Mirëkuptimit ndërmjet Drejtorisë Rajonale Kufitare Perëndimi Kosovë dhe Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Kukës-Shqipëri “Mbi implementimin e protokollit të bashkëpunimit të patrullimeve të përbashkëta përgjatë kufirit shtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë”.

3. PËRMBAJTJE

3.1 Vlerësimi i Respektimit të Protokollit dhe Mbarëvajtjes për Patrullime të Përbashkëta

3.1.1 Në respektim të marrëdhënieve miqësore ndërmjet shteteve, si dhe duke pasur parasysh legjislacionet kombëtare, detyrimet ndërkombëtare të të dy shteteve, rëndësisë së bashkëpunimit ndërkufitar për sigurinë e brendshme dhe stabilitetin e rendit publik e ligjit, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë kishin nënshkruar marrëveshjen për bashkëpunimin policor ndërkufitar.

3.1.2 Në përmbushje të nenit 13 të marrëveshjes së lartcekur “Patrullimet e përbashkëta përgjatë Kufijve Shtetëror”, Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës dhe Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë kanë nënshkruar Protokollin “Mbi patrullimin e përbashkët përgjatë kufirit shtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

3.1.3 Gjithashtu Drejtorët Rajonal të Policisë Kufitare Perëndimi-Kosovë dhe Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Kukës-Shqipëri, kanë nënshkruar Marrëveshje Teknike të Mirëkuptimit me objekt “Mbi implementimin e protokollit të bashkëpunimit të patrullimit të përbashkët përgjatë kufirit shtetëror midis kufirit të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë” ku përcaktohen edhe modalitetet përkatëse për zbatimin e protokollit.

3.1.4 Protokollin “Mbi patrullimin e përbashkët përgjatë kufirit shtetëror midis kufirit të Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë” përfshin : qëllimin e ngritjes së patrullave të përbashkëta, detyrat dhe përgjegjësit, zonën e veprimit, kompetencën, të drejtat e uniformave zyrtare, bashkërendimin e punëve, mënyrën e punës, përbërjen e patrullave, dërgimi në punë, urdhërimi, instruktimi dhe raportimi, drejtim, mjetet e komunikimit, uniforma pajisjet dhe armatimi, përgjegjësit civile dhe penale të këtyre patrullimeve të përbashkëta, trajnimet dhe analiza e veprimeve të përbashkëta.

3.1.5 Qëllimi i ngritjes së patrullave të përbashkëta është:

- Të forcohet siguria në Kufirin Shtetëror të përbashkët,
- Të pengohet migracioni ilegal,
- Të pengohet krimi ndërkufitar
- Të pengohen rreziqet e tjera të sigurisë publike,
- Të rritet cilësia e vlerësimit të sigurisë,
- Të forcohet bashkëpunimi i policive përgjatë Kufirit Shtetëror të përbashkët.

3.1.6 Detyra të patrullave të përbashkëta janë:

- Kontrolli i kufirit të përbashkët shtetëror, sipas juridiksionit territorial;
- Marrja e masave për ndalimin e personave që kryejnë veprimtari kriminale nëpërmjet kufirit dhe bëjnë bllokimin e mjeteve dhe të mallrave që hyjnë në mënyrë të paligjshme jashtë pikave të kalimit kufitar;
- Ndihma në rastet e ngjarjeve të rënda ose forcës madhore që ndodhin në afërsi të kufirit;

- Shkëmbimi i eksperiencës dhe informacionit për kushtet e sigurisë në kufirin e përbashkët shtetëror.

3.1.7 Policit kufitare të të dy vendeve në përputhje me rregullin për zonën e veprimit prej 10 kilometrash, të përcaktuar në nenin 5 të Protokollit kanë respektuar në përpikmëri kërkesat e këtij neni. Gjithashtu nuk është evidentuar asnjë rast kur palët kontraktuese të kenë aplikuar rastin përjashtues të tejkalimit të kësaj zone të veprimit.

3.1.8 Palët Kontraktuese kanë kryer detyrat e tyre duke respektuar në përpikëri çështjet që janë përcaktuar në nenin 6 të protokollit për “Kompetencat e Patrullave të Përbashkëta”, sa i përket respektimit të legjislacionit, ushtrimit të të drejtave të tjera të policisë.

3.1.9 Gjatë inspektimit nuk është evidentuar ndonjë rast ku nga palët kontraktuese nuk është respektuar neni 7 i Protokollit që fletë për të drejtat e patrullave të përbashkëta.

3.1.10 Në përputhje me nenin 8 të Protokollit për bashkërendimin e punës, Drejtoritë Kufitare Perëndimi-Kosovë dhe Kukës-Shqipëri kishin përpiluar Planin Mujor të Patrullimeve (data, koha dhe zona) për çdo strukturë lokale.

3.1.11 Sa i përket mënyrës së punës referuar nenit 9 të Protokollit, patrullimet në Republikën e Kosovës ishin organizuar me mjete dhe në këmbë, ndërsa në Republikën e Shqipërisë, për shkak të infrastrukturës rrugore ishin organizuar vetëm në këmbë.

3.1.12 Inspektimi ka evidentuar se gjatë punës ishin respektuar kriteret e e përcaktuara në nenin 10 të Protokollit e konkretisht: patrullat ishin të përbëra nga 3 punonjës respektivisht dy punonjës policie të palës pritëse dhe një punonjësi policie nga pala tjetër, është respektuar njohja e gjuhës së palëve kontraktuese, punonjësit e planëzuar në shërbim kishin marrë pjesë në trajnimet përkatëse rajonale për patrullime të përbashkëta. Mirëpo duhet theksuar se Inspektorët nuk kanë konstatuar ndonjë rast kur si rezultat i analizës së vlerësimit të riskut për çdo rast konkret është përcaktuar edhe përbërja e personelit të patrullave të përbashkëta.

3.1.13 Punonjësit policor të të dy vendeve dërgohen në punë në përputhje me nenin 11 të protokollit dhe legjislacionin e tyre kombëtar, ku punonjësit që marrin pjesë në patrullimet e përbashkëta zgjidhen nga lista e punonjësve të policisë së trajnuar, deri sa kopja e listës së patrullimit duhet ti dorëzohet oficerit të palës tjetër kontraktuese. Mirëpo, janë identifikuar raste kur kopja e listës së patrullimeve të përbashkëta nuk ju është dorëzuar oficerit të palës tjetër kontraktuese.

3.1.14 Gjatë inspektimit u evidentua se nga të dy strukturat policore kufitare kishte zbatim të pjesshëm të nenit 12 të Protokollit i cili bën fjalë për urdhërimin e patrullave të përbashkëta e konkretisht:

- a) Nga autoriteti kompetent i policisë së Palës Kontraktuese në territorin e shtetit në të cilin është kryer patrullimi, ishte nxjerrë urdhër shërbimi por jo në të gjitha rastet me një kopje të tij ishte pajisur edhe pala tjetër siç e parashikon protokollin.
- b) Nga strukturat policore kufitare ishte bërë pajisja e zbatuesve të Protokollit me formularët përkatës të patrullave, por ato nuk plotësoheshin në të gjitha rubrikat.

3.1.15 Në nenin 13 përcaktohet se Instruktimi i patrullave bëhet nga përgjegjësi i Turnit ose Shefi i Stacionit, të cilët në bazë të dinamikës mund të vendosin edhe ndryshimin e segmentit. Nga verifikimi rezultoi se instruktimi ishte bërë në të gjitha rastet duke përcaktuar edhe detyrat përkatëse, por nuk është evidentuar asnjë rast kur nga eprorët të ishte bërë ndryshimi i segmentit. Përfundimi i patrullimeve kërkon përpilim të raportit me të cilin palët kontraktuese pajisen me nga një kopje të tij, por duhet theksuar se sa i përket përpilimit të raportit respektohet neni në fjalë mirëpo jo në të gjitha rastet pala tjetër pajiset me një kopje të raportit.

3.1.16 Drejtimi i patrullave të përbashkëta sipas nenit 14 të Protokollit, është kompetencë e punonjësit policor të stacionit policor në zonën e të cilit është kryer patrullimi gjë e cila gjithnjë është respektuar nga policitë e të dy vendeve të cilët kanë qenë përgjegjës për shërbimin dhe raportimin.

3.1.17 Vlen të theksohet që sa i përket mjeteve të policisë, mjeteve të komunikimit, uniformës pajisjeve dhe armatimit, veprimeve, përgjegjësisë penale dhe civile punonjësit policor si dhe trajnimi strukturat policore të të dy vendeve kanë respektuar pikat që i ka precizuar protokollin qoftë edhe në rrethana të mos përballjes me ndonjë situatë të paraparë në disa pika të protokollit.

3.1.18 Të dy strukturat policore kufitare në nivelin qendror dhe rajonal përpilojnë raporte analiza të veprimtarisë të përgjithshme sa i përket angazhimeve në mbikëqyrjen e kufirit, por nuk kanë prezantuar dokumente që vërtetojnë përpilimin e raporteve - analizave të veprimtarisë me theks të veçantë për patrulla të përbashkëta siç edhe e përcakton Protokollin. Ndërsa niveli lokal i dy strukturave policore ka prezantuar raporte mujore sa i përket patrullimeve të përbashkëta duke respektuar rregullin e përcaktuar në protokoll.

3.1.19 Për më tutje, Policitë Kufitare të të dy vendeve në pajtim të implementimit të protokollit të bashkëpunimit të patrullimeve të përbashkëta përgjatë kufirit shtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë kanë nxjerr Marrëveshjen Teknike të Mirëkuptimit në të cilën janë paraparë çështjet siç janë: zonat e patrullimit, oraret mujore të patrullimeve të bazuara në analizën dhe vlerësimin e rrezikut, kohëzgjatja dhe numri i patrullimeve, orarin (grafikun) e angazhimeve, çështjet administrative si dhe takimet e analizat.

3.1.20 Drejtoritë Rajonale Policore Kufitare të të dy vendeve kanë respektuar nenin 1 të Marrëveshjes Teknike të Mirëkuptimit i cili përcakton se “patrullimet e përbashkëta të realizohen përgjatë tërë kufirit shtetëror që e ndanë Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë, me të cilën rast zona e patrullimit të përbashkët të përcaktohet me orar mujor bazuar në analizën dhe vlerësimin e rrezikut të përpiluar nga pala kontraktuese në territorin e së cilës realizohet patrullimi i përbashkët”.

3.1.21 Marrëveshja Teknike e Mirëkuptimit në nenin 2 përcakton; “Palët në këtë marrëveshje teknike kanë vendosur që gjatë një muaji të realizohen jo më pak se 20 patrullime të përbashkëta” dhe kohëzgjatja e tyre nuk duhet të jetë më e shkurt se 4 orë por jo më e gjatë se 6 orë. Për vitin 2015 ishin planifikuar në bazë të planeve mujore nga strukturat në të dyja anët e kufirit **240 patrullime të përbashkëta** (respektivisht nga 20 në muaj), dhe ishin **realizuar 168**. Stacionet policore kufitare Vërmic, Ponošec, Dragash, Morinë, Shishtavec dhe Qafë Morinë

kanë respektuar në përpikëri oraret e caktuara në këtë marrëveshje duke mos tejkaluar min-max e kohës së patrullimeve të përbashkëta.

3.1.22 Dokumentacionet e kontrolluara kanë treguar se Orari (Grafiku) i angazhimeve përpilohet një herë në çdo muaj nga palët kontraktuese, secila për territorin e vetë të përgjegjesisë duke u bazuar në raportet e vlerësimit dhe analizimit të rrezikut, siç përcaktohet në nenin 3, pika 1 dhe 2 e Marrëveshjes Teknike të Mirëkuptimit. Në pikën 3 të po këtij neni theksohet se palët janë pajtuar që vetëm për muajin e parë të fillimit të patrullimeve të përbashkëta secila nga to të përpilojë nga 10 patrullime, dhe më pastaj në takimet e përbashkëta mujore të diskutojnë për ndryshimin e këtij reciprociteti gjithnjë duke u bazuar në analizën dhe vlerësimin e rrezikut, gjë e cila referuar dokumentacioneve relevante nuk ka rezultuar me ndonjë ndryshim të këtij reciprociteti.

3.1.23 Për shpjegime të mëtejme, në nenin 3 pika 5, kërkohet që me orar (grafik) mujor të caktohet data, koha dhe vendi i takimit, kurse zona dhe drejtimi i patrullimit është kompetencë e udhëheqësit të patrullës. Sa i përket datës, kohës dhe vendit të takimit respektohet me përpikëri, kurse duhet theksuar se nuk respektohet kompetenca e përcaktimit të zonës së patrullimit, pasi që edhe zona e patrullimit përcaktohet nga niveli rajonal.

3.1.24 Detyrat administrative në Marrëveshjen Teknike të Mirëkuptimit lidhur me afatet kohore të përpilimit dhe dërgimit të orareve (grafiku) është vënë në pah se respektohen nga palët kontraktuese. Ndërsa kopjet e procesverbaleve tregojnë për takime të përbashkëta në mes strukturave policore kufitare të cilat në përputhshmëri me marrëveshjen realizohen në stacionet e kontrollit kufitar Vërmic-Morinë. Ajo që ka veçuar këto procesverbale të takimeve është mos prezenca e komandantëve të stacionit policor për mbikëqyrje të kufirit Ponoshec nga ana e Republikës së Kosovës dhe atyre të Qafë Morinës dhe Shishtavecit nga ana e Republikës së Shqipërisë.

3.2. Vlerësimi i performacës policore dhe rezultatet e patrullimeve të përbashkëta në luftën ndaj emigracionit ilegal dhe krimit ndërkufitar

3.2.1 Drejtoria Rajonale Policore Kufitare Perëndimi-Kosovë dhe Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Kukës-Shqipëri, dallojnë në strukturimin e tyre organizative gjersa në funksion dhe përmbajtje kanë detyra dhe përgjegjësi të njëjta. Referuar Strukturës organizative DRPK-së Perëndimi Kosovë, sa i përket vijës kufitare me Republikën e Shqipërisë në varësi të saj strukturore ka katër stacione të pikë kalimeve kufitare dhe katër stacione policore kufitare për mbikëqyrje të kufirit, kurse bazuar në Organikën e DVKM- së Kukës-Shqipëri, në vijën kufitare me Republikën e Kosovës është e organizuar në katër stacione policore të cilat bashkërisht kryejnë detyrat e pikë kalimit kufitar dhe mbikëqyrjes së kufirit.

3.2.2. Sa i përket burimeve njerëzore Drejtoria Rajonale Perëndimi-Kosovë, ka një numër prej 150 punonjësish dhe Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Kukës-Shqipëri, në strukturat e saj ka 46 punonjës, ku si detyrë funksionale punonjësit e të dy strukturave kanë kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit me gjatësi prej 123 kilometra vijë kufitare.

3.2.3 Vlen të theksohet se strukturat e policisë kufitare të Republikës së Kosovës disponojnë logjistikë (automjete të përshtatshme për terrene të thyera, për dimër dhe mjete monitoruese për natën, kamera et), ndërkohë që në palën shqiptare pajisjet logjistike lënë për të dëshiruar dhe në kuadër të bashkëpunimit nga strukturat policore kishte filluar zbatimin e Protokollit për “Shfrytëzimin e përbashkët të pajisjeve për kontrollin e kufirit”.

3.2.4 Përkundër faktit të një raporti jo të drejtë në mes burimeve njerëzore, dhe vijës kufitare prej 123 km, policitë e të dy vendeve kanë realizuar patrullimet e përbashkëta të cilat kanë treguar rezultatet e tyre në parandalimin e krimit ndërkufitar dhe emigracionit.

3.2.5 Patrullimet policore të cilat në detyrat policore hynë në kategorinë e kryerjes së detyrave me uniformë policore-shërbim i hapur kanë rol preventiv ndaj veprimtarive kriminale. Andaj, realizimi i një numri të konsiderueshëm të patrullimeve të përbashkëta prej 168 të tilla, në mes dy strukturave policore tregon angazhimin serioz të tyre në luftimin e krimit ndërkufitar. Duke vënë në theks që migracioni, dhe krimet ndërkufitare janë të përditësuar, patrullimet e përbashkëta në mes dy strukturave policore referuar të dhënave statistikore nuk kanë treguar rezultat në zbulimin e veprave penale si angazhim i tyre konkret.

4. PËRFUNDIMET

4.1 Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare Perëndimi-Kosovë dhe Drejtoria Vendore e Policisë Kufitare dhe Migracionit Kukës-Shqipëri, gjatë kryerjes së patrullimeve të përbashkëta janë mbështetur në Protokollin ndërmjet “Ministrit të Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës dhe Ministrit të Brendshme të Republikës së Shqipërisë”. Po ashtu në implementimin e protokollit të bashkëpunimit të patrullimeve të përbashkëta (përziera) përgjatë kufirit shtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, DRPK Perëndimi-Kosovë dhe DVKM Kukës-Shqipëri janë pajtuar duke nënshkruar “Marrëveshje Teknike të Mirëkuptimit”. Protokollin dhe Marrëveshjen Teknike të Mirëkuptimit në masën më të madhe të tyre janë respektuar nga dy drejtoritë rajonale policore kufitare, deri sa janë identifikuar çështje ligjore, organizative, evidentuese dhe kapacitete njerëzore që kërkojnë angazhime për tu respektuar në plotësi dokumentet e sipërpërmendura.

4.2 Në respektim të Protokollit, stacionet policore të të dy drejtorive rajonale dërgimin në punë të patrullave të përbashkëta në territorin shtetëror të palës tjetër kontraktuese është bërë nga radhët e oficerëve të policisë së trajnuar. Mirëpo është identifikuar që në disa raste kopjet e listës së patrullimeve të përbashkëta nuk ju kanë dorëzuar oficerit të policisë së Palës tjetër kontraktuese.

4.3 Në përputhje me Protokollin, urdhërimi i patrullave në të dy strukturat policore urdhërohet me urdhër shërbim (sipas modelit 1 bashkëlidhur me protokollin), por janë evidentuar raste kur disa nga hapësirat e këtij dokumenti nuk plotësohen, si dhe disa nga kopjet e urdhër shërbimit nuk ju kanë dorëzuar oficerit policor të palës tjetër kontraktuese.

4.4 Instruktim i patrullimeve të përbashkëta është realizuar në përputhje me rregullin e përgjithshëm nga ana e përgjegjësit të turnit, por në asnjë rast patrullimet e përbashkëta nuk ka pasur angazhime të drejtuesve të stacionit për të vendosur ndonjë vend tjetër të instruktimit, të drejtë të cilin e ka paraparë Protokollin.

4.5 Referuar Protokollit, deri sa niveli lokal policor i të dy strukturave ka treguar angazhimin drejt zbatimit të rregullit ligjor për të përpiluar raporte – analiza të veprimtarisë sa i përket patrullimeve të përbashkëta, të gjeturat tregojnë se të dy strukturat policore kufitare në nivelin qendror dhe rajonal përpilojnë raporte analiza të veprimtarisë të përgjithshme sa i përket angazhimeve në mbikëqyrjen e kufirit, por nuk kanë prezantuar dokumente që vërtetojnë përpilimin e raporteve – analizave të veprimtarisë me theks të veçantë për patrulla të përbashkëta siç edhe e përcakton Protokollin.

4.6 Raportimi i patrullimeve të përbashkëta (niveli lokal) është bërë nga ana e palës kontraktuese në territorin e së cilës është kryer patrullimi por të gjeturat kanë treguar se jo në të gjitha rastet pala pritëse ka pajisur me kopje të raportit palën tjetër kontraktuese ashtu siç e kërkon Protokollin.

4.7 Të dy Drejtoritë Rajonale Kufitare sipas orareve (grafikut) të patrullimeve të përbashkëta kanë planifikuar nga 20 patrullime për çdo muaj me qëllim të respektimit të bazës ligjore, gjë të cilin nuk kanë arritur ta përmbushin në plotësi për shkak se të dy Drejtoritë Rajonale Kufitare së bashku kanë realizuar 168 patrullime të përbashkëta duke bërë që të mos përmbushet detyrimi

ligjor për të realizuar jo më pak se 20 patrullime në muaj, detyrim që rrjedh nga Marrëveshja Teknike e Mirëkuptimit.

4.8 Oraret (Grafiku) e patrullimeve të përbashkëta kanë rezultuar të kenë nga 10 patrullime të shënuara duke respektuar marrëveshjen në mes palëve e cila ka vlejtur vetëm për muajin e parë të fillimit të patrullimeve të përbashkëta. Mirëpo palët kontraktuese nuk kanë prezantuar ndonjë angazhim me të cilin do të vërtetoheshin diskutimet për ndryshimin e reciprocitetit të numrit të patrullimeve gjithnjë duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe analizës të të dy palëve kontraktuese siç e parasheh Marrëveshja Teknike e Mirëkuptimit.

4.9 Në respektim të Marrëveshjes Teknike të Mirëkuptimit takimet në mes dy Drejtorive Policore Kufitare realizohen duke treguar angazhimet e tyre përmes procesverbaleve të takimit. Mirëpo këto procesverbale kanë identifikuar se përgjegjësit e stacioneve policore Ponoshec-Kosovë dhe Qafë Morinë - Shqipëri nuk kanë qenë pjesëmarrës në asnjërin takim të mbajtur nga dy palët .

4.10 Përkundër faktit të një raporti jo të drejtë të burimeve njerëzore, të dy strukturat policore kanë realizuar detyrat e tyre duke kryer patrullime të përbashkëta gjë e cila ka treguar efikasitet në parandalimin e veprave kriminale ndërkufitare. Sa i përket goditjes së veprave penale ndërkufitare, ky tregues lë ende për të dëshiruar, por ky nuk ndikon në performancën e strukturave, pasi qëllimi kryesor i patrullimit të përbashkët është parandalimi dhe bashkëpunimi policor.

5. REKOMANDIMET

Në drejtim të përmirësimit dhe ngritjes së vazhdueshme të performancës së personelit policor, IPK-SHÇBA nxjerrin këto rekomandime kryesore:

5.1 IPK-SHÇBA rekomandon udhëheqësve të stacioneve policore kufitare Kosovë – Shqipëri të cilat realizojnë patrullime të përbashkëta që ti pajisin me kopje të listës së patrullimeve oficerët e policisë së palës tjetër Kontraktuese.

5.2 IPK- SHÇBA rekomandon drejtuesit e stacioneve policore Kosovë-Shqipëri përmes mbikëqyrjes të sigurohen që oficerët policor të cilët bëjnë patrullime të përbashkëta ti plotësojnë të gjitha hapësirat që i ka paraparë urdhër shërbimi.

5.3 IPK-SHÇBA rekomandon drejtuesit e stacioneve policore Kosovë-Shqipëri që sa më parë të angazhohen në drejtim të caktimit të ndonjë vendi tjetër të instruktimit, sipas përcaktimeve të protokollit për patrullime të përbashkëta.

5.4 IPK- SHÇBA rekomandon niveleve qendrore dhe rajonale që sa më parë të angazhohen në drejtim të përpilimit të raporteve/analizat e vlerësimit të veprimtarisë së patrullave të përbashkëta me qëllim respektimin e rregullit të përcaktuar në protokoll për patrullime të përbashkëta përgjatë kufirit shtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

5.5 IPK-SHÇBA rekomandon udhëheqësit e stacioneve policore Kosovë-Shqipëri të cilat realizojnë patrullime të përbashkëta që ti pajisin me kopjen e raporteve të patrullimeve oficerët e policisë së palës tjetër Kontraktuese.

5.6 IPK-SHÇBA rekomandon përgjegjësit e të Dy drejtorive rajonale policore të Kosovës-Shqipërisë që të angazhohen në gjetjen e ndonjë mënyre përmes së cilës do të përmbushnin kriterin e përcaktuar sa i përket realizimit të patrullimeve të përbashkëta.

5.7 IPK-SHÇBA rekomandon përgjegjësit e të dy drejtorive rajonale policore të Kosovës-Shqipërisë që në oraret (grafikonet) e tyre të ketë ndryshim të reciprocitetit lidhur me numrin e patrullimeve të përbashkëta.

5.8 IPK-SHÇBA rekomandon udhëheqësve të të dy drejtorive rajonale policore kufitare që në vazhden e takimeve të përbashkëta të kenë kujdesin e shtuar për pjesëmarrje të të gjitha stacioneve policore relevante.

5.9 IPK-SHÇBA rekomandon udhëheqësve të të dy drejtorive rajonale policore kufitare të angazhohen në gjetjen e modaliteteve, veprimeve, përmes së cilave do të rritet efektshmëria dhe efikasiteti sa i përket masës represive-goditjes së krimit ndërkuftar si rezultat i patrullimeve të përbashkëta.